



**Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit Universitar "Biznesi" në Prishtinë,
Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit Universitar "Biznesi" më
14. 07. 2010 miratoi këtë:**

RREGULLORE

PËR POLITIKAT E MOSDISKRIMINIMIT DHE TRAJTIMIT TË BARABARTË NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "BIZNESI"

1. Politikat e Kolegjit Universitar "Biznesi" (KU "Biznesi") kanë për qëllim të krijojnë kushte, në të cilat të gjithë studentët dhe personeli të trajtohen me respekt dhe të mos i nënshtrohen diskriminimit të padrejtë, në çfarëdo aspekti të jetës së KU "Biznesi".

KU "Biznesi" nuk e pranon diskriminimin mbi bazë gjinie, race, ngjyre, etnike ose shoqërore-ekonomike, të rrethanave familjare, fesë, bindjeve politike, orientimit seksual ose të ndonjë dallimi tjetër të parëndësishëm, si dhe është i angazhuar të punojë me diversitet në një mënyrë tërësisht pozitive.

Gjithë personeli dhe studentët, ata ekzistues ose potencial, sigurohen se në KU "Biznesi" kanë trajtim të barabartë dhe korrekt, kudo që bëjnë kërkesë ose aplikacion kur do të punojnë si anëtarë të KU "Biznesi".

Me qëllim që të arrihet barazia e mundësive, KU "Biznesi" angazhohet të sigurojë që:

1.1 të zbatohen procedura korrekte dhe të barabarta lidhur me marrjen në punë, përzgjedhjen dhe ngritjen e personelit;

1.2 procedurat të sigurojnë trajtim korrekt dhe të barabartë lidhur me pranimin dhe vlerësimin e studentëve;

1.3 mjediset e mësimdhënies, të të mësuarit dhe të kërkimit të jenë të hapura për të gjithë;

1.4 mbikëqyrja e këtyre procedurave të kryhet rregullisht krahas me mbikëqyrjen e fuqisë punëtore dhe popullsisë studentore të KU "Biznesi";

1.5 procedurat ekzistuese të rishikohen dhe të shqyrtohen për të siguruar që nuk janë diskriminuese gjatë veprimit të tyre;

1.6 të përpunohet një procedurë për të zgjidhur ankesat mbi diskriminimin dhe t'u komunikohet atyre që mund të kenë nevojë ta përdorin;

1.7 gjuha e përdorur në komunikimet zyrtare të pasqyrojë frymën e kësaj politike;


1.8 shkeljet e rënda të kësaj politike të trajtohen me procedura disiplinore.

2. Nga personeli dhe studentët pritët që ta mbështesin këtë politikë aktivisht, të pranojnë parimin që ofron mundësi të barabarta për secilin në të gjitha aspektet e jetës së KU "Biznesi" dhe të mos marrin pjesë në situatat të cilat mund të çojnë në diskriminimin e padrejtë.

3. Çdo shkelje dhe mosrespektim i politikës për mundësi të barabarta, nga ana e studentëve ose personelit, do të trajtohet seriozisht nga organet kompetente të KU “Biznesi” në varësi nga shkeljet përkatësisht mosrespektimi i politikave për mundësi të barabarta.

Në rast të shkeljeve më të rënda do të ndërmerren edhe masa të tjera në pajtim me ligjin.

4. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së miratimit kurse iniciativën për ndryshimet e Rregullores mund ta paraqesë 1/3 e anëtarëve të Bordit ose Këshillit.



Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan